



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilački Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council  
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

DPSKPK/Nr. 649 /2024  
Datë: 19 dhjetor 2024

Në bazë të nenit 32 paragrafi 1 nën paragrafët 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 paragrafët 2, 3, 4 dhe 5 të Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurat e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional dhe nenit 8 paragrafët 1, 2 dhe 4 nën paragrafi 4.9 të Rregullores Nr. 02/2023 për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Për shpalljen e konkursit për Bashkëpunëtor Profesional në prokuroritë e Republikës së Kosovës si në vijim:
  - 1.1.Prokuroria e Apelit të Kosovës, një (1) pozitë;
  - 1.2.Prokuroria Themelore në Prizren, një (1) pozitë;
  - 1.3.Prokuroria Themelore në Pejë, një (1) pozitë.
2. Shpallja do të jetë e hapur 15 ditë nga dita e publikimit si dhe duhet të përmbajë informatat e përcaktuara në Rregulloren Nr. 04/2022 për Procedurat e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional.
3. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim dhe shpalljen e konkursit t'i publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës dhe fizikisht në të gjitha ndërtesat e prokurorive.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Sami Istrefi



Drejtor i Përgjithshëm i  
Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës

I DORËZOHET:

- DBNJ;
- Arkivës.